

EMIL LAË

## PROBLEME E DETYRA NË FUSHËN E KULTURËS SË GJUHËS

*1. Karakteristika e përgjithshme e etapës së sotme të zhvillimit të shqipes letrare. 2. Kultura e gjuhës dhe norma gjuhësore. 3. Detyrat e sotme në fushën e kulturës së gjuhës shqipe. 4. Mbi mjetet dhe rrugët për kryerjen e këtyre detyrave.*

1. Njëzet e pesë vjetët që nga çlirimi i atdheut e deri sot janë edhe për historinë e gjuhës shqipe një periudhë zhvillimi të shpejtë e të vrullshëm, një periudhë ndryshimesh të rëndësishme në sasi e në cilësi. Kryesorja dhe më e rëndësishmja që u arrit gjatë kësaj periudhe në fushën e zhvillimit të gjuhës është se sot mund të themi pa hezitim që «*ekziston në thelb një gjuhë e vetme letrare shqipe*»<sup>1</sup> dhe «në pjesën dërmuese të strukturës fonetiko-gramatikore, fjalëformuese e leksikore të kësaj gjuhe letrare... zotëron tashmë një normë e vetme, e pranuar dhe e zbatuar nga të gjithë»<sup>2</sup>. Kjo gjuhë e vetme funksionon sot si e tillë jo vetëm në fushën e publicistikës<sup>3</sup> e të letërsisë artistike<sup>4</sup>, por edhe në të gjitha botimet shkencore, që vijin duke u shtuar dita me ditë. Si pasojë e kushteve ekonomike-politike dhe e ngritjes së përgjithshme të nivelit kulturor të masave punuese (në vendin tonë në çdo katër vetë një mëson) etapa e sotme e zhvillimit të gjuhës shqipe karakterizohet nga një gjallërim i pashembullt i procesit të normalizimit të saj dhe nga një përhapje e gjerë e normave të gjuhës letrare. Në këto rrethana kuptohet vetiu sa e domosdoshme është që gjuha, «mjeti më i rëndësishëm i komunikimit ndërmjet njerëzve (Lenin), me anën e së cilës bëhet e mundur veprimtaria njohëse e njeriut dhe gjithë përparimi shoqëror, të çlirohet nga lëkundjet, të pastrohet nga gabimet, në mënyrë që t'i kryejë sa më mirë detyrat e saj. Kjo domosdoshmëri për ne merr një rëndësi të posaçme, po të kemi parasysh kushtet e veçanta të formimit të shqipes letrare dhe nevojën e madhe e të ngutshme të kulturës sonë socialiste të përparuar për një gjuhë letrare sa më

1) Kostallari, Androkli. *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare në «Shkenca të shoqërore në shkollë»*, 2, Tiranë 1967, f. 71.

2) Po ai, *Po aty*, f. 71 v.

3) Është për t'u shënuar se edhe shtypi lokal, gazetatat «Shkumbini» e Elbasanit, «Adriatiku» e Durrësit, «Ushitima e maleve» e rrethit të Dibrës dhe «Jeta e re» e Shkodrës dalin në gjuhën letrare dhe janë bërë përçuese të normës letrare në masat e lexuesve të tyre.

4) Numri i botimeve në «variantin» letrar verior po vjen duke u pakësuar shumë, sidomos në fushën e prozës. A. Kostallari ka llogaritur se këto përbëjnë rreth 5% të botimeve të sotme shqipe (*Art. cit.* f. 66).

të njësuar, të qëndrueshme, të pasur e të pastër. Arritja e këtyre qëllimeve është detyrë e asaj dege të re të gjuhësisë, që po quhet sot përgjithësisht *kulturë e gjuhës*.

2. Termi *kulturë e gjuhës* në historinë e gjuhësisë lidhet me veprimtarinë e shkollës së Pragës, e cila, siç dihet, u kushtoi një vëmendje të veçantë studimit të shtresave të ndryshme stilistike dhe funksionale të gjuhës dhe marrëdhënjeve të gjuhës me letërsinë, artin dhe kulturën.

C'është kultura e gjuhës? Së pari, duhet thënë se, kur flasim për kulturë të gjuhës, kemi parasysh vetëm gjuhën letrare, qoftë të folur, qoftë të shkruar. «Kultura e gjuhës është kujdesi për të zhvilluar në gjuhën letrare ato veti që janë të domosdoshme për funksionin e saj të veçantë. E para prej këtyre është *qëndrueshmëria*; gjuha letrare duhet t'u shmanget të gjitha luhatjeve të panevojshme dhe të marrë një përcaktim gjuhësisht të përpiktë. Cilësia e dytë është *aftësia për të shprehur qartë dhe me përpikmëri, në mënyrë të shkathët dhe pa vështirësi, nuancat më të ndryshme kuptimore*. Cilësia e tretë është *origjinaliteti i gjuhës*, d.m.th. theksimi i atyre tipareve që kushtëzojnë karakterin e saj të veçantë»<sup>5</sup>. Duke treguar këtë kujdes, ne e shndrojmë gjuhën «nga një vegël e thjeshtë, nga një mjet i thjeshtë i pasqyrimin të botës së jashtme, në një objekt të veçantë të vëmendjes, të vrojtimit dhe të ndjenjave tona...»<sup>6</sup>. Kultura e gjuhës, pra, parakupton një ndikim të ndërgjegjshëm, të planifikuar të shoqërisë mbi zhvillimin e gjuhës letrare. Ky ndikim bëhet më i nevojshëm dhe më i fortë me ngritjen e nivelit të përgjithshëm kulturor të shoqërisë dhe me rritjen e asaj që quhet «komunikim masiv», prandaj është e kuptueshme që, ndonëse kujdesi i gjuhëtarëve dhe i shoqërisë për gjuhën nuk ka munguar kurrë, kultura e gjuhës po formohet si një degë e veçantë e gjuhësisë vetëm në këta tre-katër dhjetëvjetëshit e fundit, duke u bërë viti me vit objekt diskutimesh gjithnjë e më të gjalla në literaturën gjuhësore.

Nga ç'kriter ose nga ç'kriterë duhet të udhëhiqemi për ta vlerësuar një të dhënë gjuhësore si të rregullt, të drejtë, në pajtim me kulturën e gjuhës, ose, përkundrazi, si të parregullt a të gabuar? Për shkak se ende nuk është krijuar një bazë teorike për t'i vlerësuar objektivist faktet e ligjërit nga pikëpamja e kulturës së gjuhës, në këtë çështje ka pasur dhe ka shumë subjektivizëm, janë dhënë këshillime e janë bërë vlerësime të nisura thjesht nga shije vetjake. Kriteri i vetëm i drejtë, duke u mbështetur në të cilin mund të gjykojmë sa më objektivist për një të dhënë gjuhësore nga pikëpamja e kulturës së gjuhës, është ai që i shikon këto të dhëna nga pikëpamja e funksionit komunikativ të gjuhës, që është edhe funksioni i saj themelor. Çdo komunikim ka një qëllim të caktuar. Në rast se mjetet gjuhësore të përdorura i përshtaten qëllimit të atij komunikimi, atëherë ato mund të vështrihen si korrekte a të rregullta nga pikëpamja e kulturës së gjuhës, pra motivimi gjenetik ose «pastërtia» e formës nuk mund të jenë përcaktuese<sup>7</sup>. Ky kriter, që mund të quhet edhe kriter i përshtatshmërisë komunikative, nuk përlligj aspak gabimet dhe shman-

5) Vahek, J., *Lingvističeskij slovar' prazhskoj shkolly*, Moskva 1964, f. 109 v; Zvegincev, V. A., *Istorija jazykoznanija XIX-XX vekov v očerkah iz vlyečenijah*, II, Moskva 1965, f. 138 v.

6) Vahek J., *Po aty* f. 110; Bullygina, T. V., *Pražskaja lingvističeskaja školla në «Osnovnyje napravlenija strukturalizma»* Moskva 1964, f. 121.

7) Jakobson, R., *Die Arbeit der sogenannten «Prager Schule»*, f. 7 v. (sipas T. V. Bullygina, *Po aty*, f. 121).

gjet e ndryshme që mund të vërehen në gjuhë; thelbi i tij është që faktet gjuhësore të shikohen nga pikëpamja funksionale-stilistike<sup>8</sup>.

Me kulturën e gjuhës lidhet ngushtë koncepti mbi normën. Zakonisht me termin normë kuptohet ai përdorim i mjeteve gjuhësore, që është i pranueshëm prej të gjithëve, dhe gjithashtu tërësia e rregullave, sipas të cilave përdoren mjetet e ndryshme gjuhësore në ligjërimin e një individi<sup>9</sup>. Këtu është e nevojshme të sqarohet mirë thelbi i normës dhe të dallohet ajo nga kodifikimi<sup>10</sup>. Norma duhet parë si një tërësi mjesh të qëndrueshme (d.m.th. që përdoren rregullisht në gjuhë), pra ajo ka karakter objektiv dhe ekziston në mbarë gjuhën. Kodifikimi është njohja dhe përcaktimi i normës, pra, nuk është spontan, por i vetëdijshëm. Ai është i kushtëzuar historikisht nga njohja e kufizuar e mjeteve dhe ligjeve të gjuhës letrare, që ekzistojnë objektivisht. Kështu në binomin normë-kodifikim termi i parë shënon objektin real të asaj veprimtarie shkencore që shënon termi i dytë<sup>11</sup>. Norma, në këtë mënyrë, duhet parë si një fenomen që zhvillohet, si një kategori historike. Për këtë arsye kodifikimi mund të mbetet pas nga norma e sotme gjuhësore, ai mund të përmbajë trajta e mjete të vjetëruara, që nuk i përgjigjen përdorimit të sotëm letrar<sup>12</sup>. Megjithatë studimi i thelluar dhe i gjerë i gjuhës së sotme letrare, njohja e mirë e saj në të gjitha format e ekzistencës, na ndihmon që në kodifikimin e normës së saj në fjalorët ose në grammatikat normative të pasqyrojmë sa më drejt ligjet dhe rregullat objektive që përbëjnë këtë normë.

Vetë norma ka një natyrë të ndërlikuar. Ajo nuk duhet kuptuar në mënyrë skematike, nuk duhet marrë si diçka e izoluar, por, në përputhje me kriterin e përshtatshmërisë komunikative, duhet parë si një sistem normash me variante funksionale-stilistike. Një të kuptuar i tillë i normës nuk duhet marrë si përligjeje e çfaqjeve që «s'janë në pajtim me normën». Përkundrazi, ai synon që të përshkruajë lejimet dhe variantet e formuara në sistemin e normave në vartësi nga funksioni i shpreh-

8) Mbi këtë kriter është mbështetur në thelb parimi për zgjedhjen e fjalëve që do të përfshihen në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe»: «Vlerësimi i çdo fjale-leksmë (për ta futur ose jo në Fjalor) duhet të bëhet të radhë të parë, jo sipas burimit (dialektor, as sipas burimit letrar, por sipas vlerës së saj objektive në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare, duke marrë parasysh kryesisht dy aspekte të lidhura organikisht midis tyre: a) a i sjell fjala leksikut të sotëm letrar, të marrë në larinë e shtresave të tij stilistikore-shprehëse e të sferave të tij të përdorimit, ndonjë pasurim, zhvillim të mëtejshëm... b) në ç'raport është ajo me tendencat e gjalla të zhvillimit të leksikut të shqipes së sotme letrare... Kostallari, A., «Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe» në «Studime filologjike» 1968, 2, f. 59. v.

9) Khs. Ahmanova, O. S. «*Silovar' lingvističeskikh terminov*», Moskva 1966, f. 270.

10) Këto koncepte janë paraqitur dhe përpunuar prej B. Havranekut: «*Úkoly spisovného jazyka a jeho kultura*; «*Zum Problem der Norm in der heutigen Sprachwissenschaft und Sprachkultur*» në «Actes du Quatrième Congrès international des linguistes» Copenhague 1938 (këto vepra, për fat të keq, i njohim vetëm nëpërmjet citimesh prej të tjerëve).

11) Khs. Bullygina, T. V., *Po aty*, f. 121; Ickoviç, V. A., *Jazykovoja norma*, Moskva 1968, f. 4. vv.

12) Si shembull për këtë mund të sillët «Fjalori i gjuhës shqipe» (1954) i cili, megjithëse u hartua për të përmbushur nevojën për një fjalor praktik e të përdorshëm që të pasqyronte gjendjen e sotme... e t'udhëzonte për përdorimin e fjalëve e të trajtave të tyre» (Parathënie f. III), më një anë ka mjaft fjalë që kishin dalë nga përdorimi, më anë tjetër nuk ka përfshirë një numër fjalësh, shumica të reja, që kishin fituar një përdorim të gjerë qysh në atë kohë (më me hollësi për këtë shih Kostallari, A., *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme»* në «Buletinin për shkencat shoqërore» 1955, 4, f. 17-50.

jes, nga karakteri i aktit të të folurit, në mënyrë që të dallohen prerë «mosrespektimi i vërtetë i normave të shtresave të ndryshme dhe «loja» në mosrespektimin e tyre, e cila nuk çon në cilësimin e të folurit si jo-normativ, por, përkundrazi, mund të konsiderohet si shkalla më e lartë e kulturës së gjuhës<sup>13</sup>. Na duket me vend të sjellim këtu një vërejtje të mprehtë të Shçerbës mbi normën në gjuhën e letërsisë artistike: «autorë që të mos largohen asnjë çap nga norma, natyrisht që nuk ka — ata do të na shkaktonin një mërzi të padurueshme». «Kur te njeriu është edukuar ndjenja e normës, atëherë ai fillon ta ndjejë gjithë bukurinë e largimeve të motivuara prej saj te shkrimtarë të mirë të ndryshëm. (Unë them «të motivuara», sepse te shkrimtarët e dobët ato janë pamjaftësisht të motivuara nga përmbajtja e brendshme — prandaj këta autorë quhen të dobët)»<sup>14</sup>.

Kaktimi i normave të një gjuhe letrare ka për qëllim normalizimin e saj. Në këtë punë duhen mbajtur parasysh disa parime teorike të përgjithshme. Së pari, normalizimi duhet ta ndihmojë dhe jo ta prishë ose ta thyejë atë stabilizim që ka arritur gjuha<sup>15</sup>. Së dyti, normalizimi nuk duhet ta frenojë evolucionin e gjuhës letrare. Së treti, ai nuk duhet të thellojë dallimet në strukturë midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, në rast se këto dallime nuk kanë vlerë funksionale. Së katërti, në normalizimin e gjuhës letrare është krejt e padobishme që të privohet

13) Kostomarov, V. G., Leontjev, A. A., *Nekotorye teoreticheskiye voprosy kultury reçi*, në «Voprosy jazykoznanija» 1966 5, f. 9.

14) Cituar sipas Ickoviç, V. A., *Vep. cit.*, f. 88 v. Dëshiroj të sjell me këtë rast një shembull që më duket kuptimplotë: A. Xhuvani, njeri me shije të hollë gjuhësore, sado që me një farë tendence puriste, përmendte shpesh, kur vinte rasti, këtë frazë nga përkthimi i «Don Kishotit»: «Haxhiut i kishte rënë erë që mysafiri i tij ishte eksiq nga koka». . . (Don Kishoti i Mançes, Tiranë 1956 f. 24) dhe e shijonte shumë këtë fjalë turqishte të përdorur këtu mjeshtërisht nga Fan Noli, i cili, sipas shpjegimit të Xhuvanit, jo se nuk dinte mënyra të tjera të thëni të shqipes, si ishte *i metë, kishte një dërrasë mangut* ose *metë* etj., por e kishte zgjedhur fjalën turqishte me vetëdije të plotë, «duke u larguar nga norma», duke shkruar në kundërshtim me tendencën e përgjithshme të letërsisë artistike për pastrimin e turqizimeve, dhe me këtë i kishte shtuar portretit të Don Kishotit një tipar anadollak, për ta bërë heroin e Cervantesit sa më të ngjashëm me shokët e tij të mendimeve dhe të punëve në Shqipëri, të cilëve u venin kaq për shtat historitë e këtij romani. Kemi këtu një nga ato raste «largimesh të motivuara» nga norma, bukuria e të cilave kuptohet kur te njeriu «është edukuar» ndjenja e normës.

15) Një shembull i kritikueshëm nga kjo pikëpamje është rekomandimi i projektit të ri të drejtshkrimit që fjalët *cfilit*, *cfrat*, *cfurk*, të shkruhen me *s*-, meqë pas saj vjen një bashkëtingëllore e pazëshme (për analogji me *skalit*, *sqepar* etj.), po ashtu *cmirë* të shkruhet *smirë*, meqë në këtë fjalë bashkëtingëlloret *-m-* ndiqet nga një *-i-*, si te *smilar*. Sipas vëzhgimeve tona këto fjalë janë ngulitur në gjuhën letrare me *-c-* nistore, e cila, duhet thënë, është ruajtur si e tillë, se nuk ka qenë pa vlerë ekspresive. Shkrimi i tyre me *s*- përbën një njësim formal, pasi e shikon punën nga pikëpamja historike-etimologjike e jo nga mënyra si ndjehen sot këto fjalë. Edhe ata që e kanë prekur këtë pikë në diskutimet rreth drejtshkrimit, shumica nuk janë pajtuar me zgjidhjen e dhënë për fjalët e mësipërme. Është për t'u shënuar se edhe në «Fjalorin e gjuhës shqipe» (1954) si trajta të para jepen ato me *c-*: *cfilit*, *cfrat*, *cfurk*, *cmirë*. Një vërejtje e ngjashme mund të bëhet edhe për *sh-ç-* nistore, sidomos për fjalën *çfaqje* dhe për fjalët ku *ç*-ja ka vlerë antonimike. Nga fusha e morfologjisë, do të ishte një prishje e stabilizimit që ka arritur gjuha, po të pranohej mendimi i disave që në gjuhën e shkrimit të mos lejohet ndrimi i gjinisë në shumës për disa klasa emrash mashkullorë (*vende të bukura* etj.).

ajo nga të gjitha variantet leksikore e gramatikore<sup>16</sup>. Nga një pikëpamje kjo mund të shihet edhe si e paarësyeshme, sepse synimi drejt stabilizimit nuk duhet të çojë në një nivelim, d.m.th. në fshirjen e dallimeve të nevojshme funksionale e stilistike, nga ana tjetër gjuha letrare në këtë mënyrë do të privohej nga ato mjete që e shpëtojnë nga përsëritjet e padëshirueshme (d.m.th. mjetet e disimilimit stilistik)<sup>17</sup>. Të gjitha këto mendojmë se duhen mbajtur parasysh si në punën për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe», parimet themelore të të cilit lejojnë në mjaft raste një shkallë jo të vogël subjektivizmi në zbatimin e tyre, ashtu edhe në hartimin e tekstit të «Gramatikës së shqipes letrare», si tekst për Universitetin, pasi ato do të jenë baza e punës për kulturën e gjuhës në të ardhmen.

3. Para gjuhësisë shqiptare dalin sot një varg detyrash të rëndësishme në fushën e kulturës së gjuhës. Këtu peshojnë sidomos këto dy rrethana: së pari, norma e gjuhës letrare, me gjithë përparimet e shënuara, pjesërisht është ende në procesin e kristalizimit të saj; së dyti, kjo normë nuk është kodifikuar; mungon një fjalor normativ i shqipes letrare dhe një gramatikë përshkruese normative e tipit akademik, gjë që deri në një farë mase, e vështirëson punën. Mungojnë gjithashtu studime teorike për normën e gjuhës letrare të sotme. Nga e kaluara, krahas gjërave të mira dhe përvojës së vlefshme janë trashëguar edhe ide e mendime që shumë herë mbështeten në një diletantizëm subjektiv-estetik, nga i cili nuk jemi çliruar ende plotësisht. Del pra si një detyrë themelore, e domosdoshme dhe e ngutshme vënja e punës në baza shkencore teorike të drejta. Këtu hallka kryesore duhet të jetë njohja e normës së gjuhës letrare të sotme, argumentimi dhe përcaktimi i saj, duke u mbështetur në rrugën dhe në rrethanat e veçanta të zhvillimit të shqipes letrare dhe duke marrë parasysh tendencat e zhvillimit të saj. Kjo punë duhet të mbështetet mbi një material të pasur faktik, të nxjerrë nga vëzhgime mbi gjuhën e gjallë. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet gjuhës së folur, e cila deri tani është studjuar vetëm nga dialektologët. Në këtë mes meriton një vëmendje të posaçme ligjërimi i kryeqytetit, pasi, cilado që të jetë baza dialektore e shqipes letrare, në procesin e kristalizimit të

16) Nuk më duket i drejtë rekomandimi i projektit të drejtshkrimit (D I § 2 f. 63) që për gjithë emrat femërore më *-i* të theksuar (*mërzi, qershi, stoli, shtëpi* etj.) trajta e shumësit të jetë e barabartë me të njëjësit, duke u përjashtuar krejt trajta tjetër me mbarensën *-ra*, e cila besoj se ka një vlerë stilistike dhe jo vetëm stilistike, khs. p.sh.: Më të shumtën e kohës e kalonin duke gjuajtur e duke bredhur nëpër *gostira* (S. Drini, «Shqipja e kreshtave tona», Tiranë 1967, f. 39); Ata kishin dëgjuar shumë *historira* për ngritjen e asaj kishe në atë vend të shkretët (P. Marko, «Urata, dhia dhe perëndia», Tiranë 1967 f. 153); Këtë cilësi e kish vënë re... me kohë te ata që kishin *përgjegjësira* (P. Marko, «Stina e armëve», Tiranë 1966, f. 326); Njëherë i martonin baballarët dhe s'kishte llafe, as *dashurira*, as gjëpura (D. Shaplo, «Përtëritje», Tiranë, 1969, f. 29); Thoshin se kishte bërë *trimëria* të mëdha (Z. Sako, «Nga jeta në luftë», Tiranë 1948, f. 18). Sado që... po kryenin *mrekullira*, gjendja sa vinte keqësohej (Gj. Zheji, «Muret e Krujës», Tiranë 1968, f. 312) etj. Po kështu do të ishte e paarësyeshme që në një vepër letrare shkrimtari ose korrektori ta njësonte gjuhën në një mënyrë të tillë, që edhe në të folurit personazheve fshatarë të brezit të vjetër ose të mesëm, të mos kishte asnjë kallëzore me *-ën/-në* (natyrisht për emrat e lak. I e II), por të bëheshin të gjitha me *-in, -un*. Dallimi i këtyre trajtave të kallëzores mund të thuhet se ka fituar një vlerë sociale. Nuk do të ishte e drejtë nga kjo pikëpamje as dhënja e një rregulli të vetëm për përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin, për rastet kur mund të zbatohet një *constructio ad seusum*.

17) Për të gjitha këto shih Vahek, J., *Vep. cit.* f. 136.

normës ky ligjërim ka filluar të luajë një rol me rëndësi, i cili, vetëkuptohet, do të jetë edhe më i madh, bile vendimtar<sup>18</sup>.

Studimet teorike dhe vëzhgimet e mbledhja e materialit për një kartotekë të veçantë të kulturës së gjuhës, duhet të shkojnë krahas me përmbushjen e disa detyrave praktike që, duke i ndarë sipas degëve të gjuhësisë: leksikologji, fonetikë, gramatikë e stilistikë, mund të renditen në këtë mënyrë.

Në fushën e fjalorit problemi më i dukshëm, më shqetësues dhe më i diskutueshëm ka qenë dhe vazhdon të mbetet zëvendësimi i fjalëve të huaja. Herë pas here përsëriten fjalët e njohura të Naim Frashërit: «Është gjerë gjuha jonë dhe bukurë shumë, ka fjalë fort të mira për të vënë në vënt të fjalëve të huaja»<sup>19</sup> dhe shumë kanë përshtypjen se me pak vullnet të mirë këtu mund të arrihen përparime të mëdha. Për këtë problem është shkruar ndoshta më shumë se për çdo problem tjetër të kulturës së gjuhës, por vepra më e mirë mbetet pa dyshim libri i A. Xhuvanit, «Për pastërtinë e gjuhës shqipe» (Tiranë 1956)<sup>20</sup>. Vetë titulli i këtij libri na shtron përpara pyetjen se ç'duhet kuptuar me pastërti të gjuhës. Natyrisht është fjala për të nxjerrë jashtë shqipes atë që s'është e shqipes, por këtu na çfaqet rreziku i purizmit. Dihet se rilindasit tanë

18) Është me interes të shënojmë se me ligjërimin e Tiranës po ndodh afërsisht ajo që kish parashikuar Sami Frashëri që më 1899 për ligjërimin e Skënderbegasit, siç donte ai të quhej kryeqyteti i shtetit të ardhshëm shqiptar, i vendosur «në një nga qytetet, që ndodhen në mes të Shqipërisë». Sipas Samiut «me qenë që ndënjësit' e ti do të jenë të mbledhura nga gjithë anët' e Shqipërisë, edhe gjuha që të flitet atje, do të jetë e përzjerë që të muntjë të quhetë gjuhë' e përgjithçime e gjuhë letrarish-te e gjithë Shqipërisë» («Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhetë?», Tiranë 1962, f. 74). Në këtë mendim të Samiut vërehë vënë re se për formimin e shqipes letrare ai parakuptonte një bashkëveprim ndërdialektor (pavarësisht nga mënyra pak mekaniciste që të lë të kuptosh citati i mësipërm) dhe e shihte kryeqytetin jo vetëm si qendër të këtij bashkëveprimi, por edhe si vatrë, prej nga do të përhapej «letrarishtja» (d.m.th. norma e gjuhës letrare) në gjithë Shqipërinë.

19) Iliadhë e Omirit, Kthyerë prej N. H. F. Bukuresht 1896, f. 13. Fryma e qëndrimit të rilindasve ndaj fjalëve të huaja ka mbetur e gjallë për gati një shekull në mes të shtresave më të ndryshme të popullit tonë dhe vitet e fundit ka marrë një theksim të veçantë, duke u parë edhe nga pikëpamja politike, çka vihet re në kërkesat e shumta të këtij lloji që ka Shërbimi i këshillimeve gjuhësore, bile deri për zëvendësimin e emrave të huaj të ëmbëlsirave. Shpesh ndodh që të zëvendësohen fjalë të huaja edhe pa pritur rekomandimet e gjuhëtarëve. Një shembull tipik është zëvendësimi i *turnit* me *ndresë*. Edhe në shtyp botohen herë pas herë artikuj mjaft të vlefshëm që ngrenë me forcë këtë çështje dhe bëjnë njëkohësisht edhe propozime mjaft të goditura (shih p.sh. Mark Kovaçi, *Për një terminologji të pastër ushtarake* në «Luftëtari» 23. V. 1968). Përballë kësaj tendence të përgjithshme të shoqërisë sonë bie në sy për keq puna e dobët e redaksive të disa gazetave e revistave që lejojnë në organet e tyre mjaft fjalë të huaja të panevojshme.

20) A. V. Desnickaja i ka cilësuar disa nga zëvendësimet e propozuara në këtë libër si qëndrim purist, por, për sa u takon një numri turqizmesh si *boll*, *javash*, *karshi*, *qoshe* etj. të cilësuar prej saj si «të rrënjosura thellë në gjuhë dhe të asimiluara plotësisht», në bashkohemi, përkundrazi, me qëndrimin e A. Xhuvanit (shih A. V. Desnickaja, *O stilistiçeskoj funkcii turcizmov v allbanskoj poezii* në «Voprosy teorii i istorii jazyka» Sbornik v cest' professora B.A. Llarina, Leningrad 1963, f. 92). Fjalët e mësipërme janë diferencuar stilistikisht në gjuhën shqipe, p.sh. fjala *qoshe* pësoi një gjallërim të përdorimit të saj në shprehjet *qoshe e rehatshme*, *qoshe e ngrohtë*, sidomos vitet e fundit, kur, me revolucionarizimin e gjithanshëm të jetës së vendit, ku kritikuan me forcë ata që i shmangeshin punës aktive prodhuese dhe mundoheshin të siguronin për vete një «qoshe të rehatshme», duke çfaqur kështu një mendësi të ngjashme me atë të shtresave burokratike të privilegjuara të ish-Përandorisë Osmane, gjatë sundimit të së cilës në Ballkan hynë në gjuhën shqipe edhe fjalët e mësipërme.

kishin prirje puriste<sup>21</sup>, dhe kjo ka arësytet e veta kulturele-historike. Sot, duke ruajtur gjithmonë atë dashuri të zjarrtë që kishin ata për gjuhën amtare, duhet ta shikojmë çështjen më gjerë e më thellë dhe më me kujdes. Një purizëm i tepëruar do të ishte i dëmshëm për gjuhën letrare, sepse do ta varfëronte fjalorin dhe do të çonte në një polisemi të padëshirueshme dhe në një lidhje shumë të madhe të termave me fjalët e përdorimit të përditshëm, çka do t'i ngarkonte termat me asociacione të tepërta e me nuanca afektive<sup>22</sup>. Kryesisht këtu dhe jo te propagandimi i dobët ose mungesa e dëshirës nga njëri a tjetri, duhet kërkuar arësyeja që një pjesë e fjalëve të kritikuarra ng A. Xhuvani si *absolut, artificial, instaloj, komplet, provokoj, renegat* etj. nuk u zëvendësuan dhe po vazhdojnë të përdoren. Purizmi i tepëruar sjell një farë arkaicizmi të gjuhës, çka duket se bie në kundërshtim me shijen e përgjithshme gjuhësore të sotme. Kështu p.sh. *mtoj* dhe *mtesë*, kurrsesi nuk mund të zënë vendin e *pretendoj* dhe *pretendim* (shih «Fjalori i gjuhës shqipe» 1954 s.v.). Por kjo nuk do të thotë që të mbajmë qëndrim indiferent ndaj fjalëve të huaja. Kur janë të panevojshme, ato bëhen pengesë për marrëveshjen ndërmjet njerëzve dhe duhen zëvendësuar qoftë edhe në një pjesë të sferës së përdorimit të tyre, (p.sh. vërtet emri *veta-t*, që përdoret vetëm në shumës, nuk mund të zëvendësojë plotësisht fjalën e huaj *person* (khs. p.sh. *person zyrtar*), por në vend të *dy veta* s'ka pse të thuhet *dy persona*). Kjo punë nuk duhet të vonohet më tej. Është e nevojshme të caktohet se cilat fjalë janë të zëvendësueshme dhe cilat jo. Të parat duhen botuar në formë të një «Fjalori të fjalëve të huaja të zëvendësueshme», i cili të shtohet, të pasurohet dhe të përmirësohet vazhdimisht, duke u ribotuar herë pas here. Për këtë duhet krijuar një kartotekë e posaçme, ku të pasqyrohet përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën letrare të sotme dhe duhet shqyrtuar gjithë puna e bërë deri më sot në këtë fushë, për të ndarë ç'është e vlefshme e ç'nuk mund të hyjë më në punë. Zëvendësimi i fjalëve të huaja kërkon natyrisht një njohje të mirë të mënyrave të fjalëformimit të shqipes. Kjo mbetet si një detyrë shumë e ngutshme dhe me rëndësi teorike e praktike të dorës së parë, veçanërisht për terminologjinë. Siç dihet, deri më sot janë botuar 15 fjalorë terminologjikë, me një shumë të përgjithshme prej 20.984 termash, dhe disa të tjerë janë duke u punuar nga Sektori i terminologjisë, i cili po i bën ballë një pune të vështirë e të vë-

21) Nuk e quajmë të nevojshme të sjellim atë varg termash të shqipëruara si dheshkronjë (=gjeografi), *dhemasë* (=gjeometri) etj. që përmenden zakonisht me këtë rast, por duam të shtojmë se Samiu ka shkruar gjer atje sa të zëvendësojë edhe mbaresën *-llarë* te emri *baballarë* (baballarët e teqeve), duke ja formuar shumësin këtëj emri me mbaresën *-nj*: *babanj* (vep. cit. f. 84).

22) Në kritikën e botuara për fjalorët terminologjikë janë vënë në dukje shembëlla të kësaj natyre. Nga fusha e gjuhësisë mund të përmendim përpjekjen pa sukses për zëvendësimin e *termit* me *skaj* («Në terminologjinë shkencore e teknike u shtinë *skajet* më të përdorura... «Fjalori i gjuhës shqipe», Tiranë 1954, Parathënie f. III). Është interesante të përmendim edhe pikëpamjen e dy inxhinjerëve gjeologë lidhur me këtë çështje: «Puna që është bërë në shqipërimin e disa termave është e mirë dhe duhet të shpiket edhe më tej, duke shfrytëzuar mundësitë e shumta të gjuhës sonë. Në këtë drejtim nga disa mund të dalin kundërshtime për përdorimin e një fjale me prejardhje shqipe, por jo shumë të dëgjuar. Mendojmë se është më mirë që të përtërihen ose të shërbejnë si rrënjë fjalë shqipe që sot nuk para përdoren, qofshin edhe dialektore, sesa të përdoren fjalë të huaja. Por kjo nuk duhet të na çojë në anën e kundërt, që të përpiqemi të shqipërojmë edhe fjalët ndërkombëtare që përbëjnë fondin bazë të specialitetit. Shqipërimi i tyre në shumë raste jo se është i zorshtëm për t'u bërë, por nuk është i arësveshëm dhe i dobishëm, meqenëse sjell vetëm ngatërresa» (Stavri Buri, Pajtim Bejtja, *Disa vërejtje mbi fjalorin «Terminologjia e gjeologjisë»* në Buletin i USHT, Serbia shkencat natyrore 1967 1, f. 116).

limshme. Çështjes së terminologjisë i duhet dhënë një rëndësi edhe më e madhe, sepse sot një numër gjithnjë e më i madh termash po hyjnë në leksikun e përgjithshëm të gjuhës. Leksiku terminologjik dhe leksiku i përgjithshëm sa vinë e po afrohen njëri me tjetrin<sup>23</sup>. «Rritja e peshës specifike të terminologjisë në leksikun e përgjithshëm përbën një tipar dallues të rëndësishëm të shqipes letrare të pasqirimit»<sup>24</sup>. Te ne punimet teorike në fushën e terminologjisë mungojnë. Besojmë se është koha që, pa lënë mënjatë hartimin e fjalorëve të rinj, të bëhet një shqyrtim e përgjithësim teorik i punës së kryer deri tani, duke studjuar një numër çështjesh, si tipet e mënyrat më produktive të formimit të termave, parimet e përkryerjes dhe të pastrimit të terminologjisë, kriteret e terminologjizimit të fjalëve dialektore, pajtimin e termave me normat e gjuhës letrare etj.

Në fushën e leksikut një detyrë tjetër e rëndësishme e kulturës së gjuhës është luftimi i përdorimeve të gabuara të fjalëve. Këto përdorime të gabuara dëmtojnë përpikërinë e qartësinë e gjuhës dhe fuqinë e saj shprehëse. Në këtë mes duhen dalluar gabimet tipike dhe të përsëritura nga ato gabime që janë krejt të rastit ose individuale. Në letërsinë artistike duhet luftuar përdorimi i tepëruar i fjalëve të leksikut lokal, siç vihet re p.sh. te disa shkrimtarë nga anët e Korçës që kanë lëshuar në letërsinë artistike një numër jo të pakë sillavizmash të panevojshme. Në gjininë e publicistikës, përveç një përdorimi të tepëruar fjalësh të huaja, vihen re edhe gabime në përdorimin e fjalëve shqipe dhe një varfëri e fjalorit. Është e papranueshme nga pikëpamja stilistike përdorimi i fjalëve e i shprehjeve karakteristike për një gjini gjuhësore në një gjini tjetër<sup>25</sup>. Kjo është një fushë mjaft më e vështirë nga ç'duket në vështrim të parë. Për të arritur në përfundime objektive dhe të pranueshme, duhet studjuar se si kanë ndryshuar kohë pas kohe ligjet e përdorimit të fjalëve dhe ç'zhvillime stilistike kanë ndodhur.

Një tjetër fushë ku gabimet ose mungesa e normës së njësuar bien në sy menjëherë është struktura fonetike e gjuhës, posaçërisht drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi. Ka gati tre vjet që drejtshkrimi po vazhdon të mbetet në qendër të diskutimit rreth çështjeve gjuhësore në shtypin tonë. Për herë të parë diskutimi i tij po merr një karakter të tillë masiv<sup>26</sup>. Shumica e rregullave të projektit janë miratuar nga diskutuesit.

23) Prandaj, edhe në qoftë i vërtetë konstatimi se «Huazimet e drejtpërdrejta të shqipes nga gjuhët e tjera, të para në një vijë tërësore, sidomos në këto 25 vjetët e fundit kanë ardhur duke zënë një vend gjithnjë më të vogël (kryesisht në fushën e terminologjisë tekniko-shkencore)» Kostallari, A., *Parimet...* kjo nuk duhet të shërbejë si arsye për të mos u shqetësuar shumë. Veç kësaj, jo vetëm sot, po edhe më parë, huazimet më të reja të shqipes kanë ardhur zakonisht nëpërmjet fushës së terminologjisë tekniko-shkencore.

24) Kostallari, A., *Parimet...* f. 65. Ky gjykim i drejtë, megjithatë, besoj se nuk mund të shërbejë për të përligjur futjen në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» të termave të tilla si *ballast*, *gaubic*, *heliogravurë*, *ofort* etj., se kështu do të humbiste kufiri midis këtij fjalori dhe fjalorëve terminologjikë ose «Fjalorit të fjalëve të huaja», hartimi i të cilit është gjithashtu shumë i nevojshëm për ngritjen e nivelit të kulturës së gjuhës.

25) Është për t'u çuditur dhe njëkohësisht për t'u shqetësuar që fjalë e shprehje të gazetave kanë hyrë deri në prrallat!, p.sh. «Skilja u largu pak ene filloi me marrë një shpejtsi t'madhe për me i hikë ujkut»... «Uku shkojte vidhte gja, ene asllani po ashtu... ne i çojshim n'shtabt», «Teshetëj, mbas kësaj prove të eëjdhët, i kishin ardhë mentë breshkës...» (Folklor shqiptar I Proza popullore vëll. I, f. 47, 63, 104).

26) Shih diskutimet e botuara herë pas here në «Mësuesi» dhe «Studime filologjike» që nga viti 1967 e këtej.

Për shkak të traditës relativisht të vonë në shkrimin e shqipes, drejtshkrimi ynë paraqitet në përgjithësi i thjeshtë, por ka disa çështje që nxjerrin vështirësi serioze. Këto, për mendimin tonë, janë 1) shkrimi i ë-së së patheksuar, sidomos i ë-së paratheksore e pastheksore; 2) shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, bashkë dhe me vijë në mes, 3) vështirësitë që lindin nga qenja e bigrameve në grafinë e shqipes (për këto të fundit projekti i ri ka dhënë një zgjidhje të ndryshme nga ajo e projekteve të mëparshme). Zanorja ë e pathekse, siç dihet, ka ardhur duke u reduktuar, dhe sot në shumë pozicione ose ka rënë krejt, ose ndihet shumë dobët<sup>27</sup>. Kjo është pasqyruar edhe në shkrim, p.sh. fjalë si *amtar, atdhe, besnik, zyrtar* (nga *amë, atë, besë, zyrë*) askujt nuk i shkon në mendje të propozojë të shkruhen me -ë-, nga ana tjetër drejtshkrimi rekomandon të shkruhet *anëtar, gojëtar, kordhëtar, pjesëtojt, pjesëtim* etj. (të parat projekti nuk i ka përmendur fare). Cila është arsyeja e kësaj mungese njësie dhe ç'qëndrim duhet mbajtur? Ja një ndër çështjet e vështira që shtron drejtshkrimi i kësaj zanoreje. Këtu vështirësia, me sa duket, rrjedh, siç kanë vërejtur edhe për raste të tjera mjaft diskutues, nga mungesa e një kriteri të drejtë për kombinimin e parimit fonetik me parimin morfologjik<sup>28</sup>, për të cilët bëhet fjalë në kapitullin «Parime të përgjithshme» të projektit. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes, sado të arsyeshme të kenë qenë, nuk janë mbështetur në studime të posaçme për çështje të ndryshme. Pa këto studime, sidomos për sa i takon ë-së dhe shkrimit të fjalëve bashkë, ndaras e me vizë është vështirë të arrihet në zgjidhje tërësore e të kënaqshme. Lidhur me çështjen e dytë duhet thënë se nuk është puna vetëm për caktimin e mënyrës së shkrimit të fjalëve të përbëra e të lokucioneve ekzistuese. Kjo kategori fjalësh vjen gjithmonë duke u shtuar, prandaj duhen gjetur rregulla të qarta që të caktojnë mënyrën e shkrimit për të gjitha këto tipe. Edhe për këtë është i nevojshëm një studim monografik që t'i kushtojë vëmendje analizës së strukturës morfologjike të tyre. Qëndrimi ndaj vështirësive që lindin nga bigramet e grafisë është vërtet një çështje konvencionale dhe disa herë e fryrë si me pahir, por si mbrojtësit e zgjidhjes së projektit ashtu edhe kundërshtarët e asaj zgjidhjeje (këta më të shumtë e më të vendosur) nuk e kanë argumentuar në një mënyrë bindëse pikëpamjen e tyre.

Në fushën e drejtshkrimit ose të ortoepisë gjendja e studimeve është mjaft e varfër në krahasim me drejtshkrimin. Përpjekjet më serioze për kodifikimin e normës drejtshqiptimore janë bërë nga Anastas Dodi në artikullin «Probleme të ortoepisë shqipe dhe shkolla» («Arësimi popullor» 1962 nr. 4 ff. 91-104) dhe më pas në dispensën e tij «Fonetika e gjuhës së sotme shqipe» (Tiranë 1963). Kjo gjendje shpjegohet në radhë të parë me mungesën e një gjuhe të vetme letrare kombëtare me normë drejtshkrimore e gramatikore të njësuar, sepse siç dihet, kodifikimi i normës drejtshkrimore kryhet më vonë se dy të parat. Megjithëse nuk është arritur një njësim përfundimtar, mund të vihen re në shqiptimin e sotëm disa norma të ngulitura e disa tendenca të përgjithshme. Pas mendimit tonë këto janë: 1) shqiptimi mjaft i reduktuar i ë-së fundore (kur fjala pas saj nis me zanore ajo nuk shqiptohet fare: *moll'e kuqe*) dhe në kufi

27) Ç'thuhet për ë-në e patheksuar te Kostallari, A., *Mbi tiparet kryesore... f. 66*, sidomos në morfemat trajtë- e fjalëformuese, i takon më tepër shkrimit sesa shqiptimit, pra nuk përbën një «veçori kryesore të strukturës fonetike».

28) Parimi morfologjik në projekt është konceptuar mjaft gjerë, duke përfshirë edhe parimin historik-tradicional e etimologjik.

midis morfemave ose temave fjalëformuese (*shumëzot, miqësi, mirëbërës* etj.). Shqiptimi i plotë i ë-së në këto pozicione tingëllon sot si artificial dhe arkaik; 2) mungesa e rregullave për dallime sasimore të zanoreve të theksuara; 3) reduktimi në *u* i dyanorit *ue: mësus, e punushme* etj. dhe reduktimi *ye > y: i pathyshëm* etj. 4) kalimi i theksit nga rrokja e fundit në të të parafundit te huazimet turke si *káfe, qófte, qóshe* etj.; 5) shqiptimi i plotë i grupeve *mb, nd, ng, ngj*; 6) shtrirja e tingullit *rr* në një numër më të madh fjalësh; 7) mbizotërimi i shqiptimit me *l, d e t* në vënd të *ll, dh e th* te fjalët e huaja me burim nga greqishtja (*ideologji, metodë, ortodoks* etj.).

Ende nuk mund të thuhet se ka arritur të bëhet i përgjithshëm mosshurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës dhe para një të pazëshmeje në trup të fjalës, megjithëse për grupet *mb, nd, ng, ngj* e për *-v-* në na duket se kjo mënyrë shqiptimi ka ecur më përpara. Po ashtu huazimet e reja dhe disa emra të përveçëm nuk i nënshtrohen rregullës së shurdhimit, p.sh. *ajsberg, kolkoz, personazh* (dhe të gjithë emrat e tjerë me *-azh*), *Molotov, Mekong, Lvov* etj. Për të gjitha ato raste ku ka lëkundje në shqiptim, zgjidhja më e drejtë parimisht mendojmë se do të jetë ajo që pajtohet me normën e drejtshkrimit, e cila, ndërkaq, duhet thënë se po ndikon në mënyrë të ndjeshme mbi shqiptimin. Të njëjtën gjë do të themi edhe për lëkundjet në shqiptimin e *e-së* së theksuar para një hundoreje. ku krahas trajtave tashmë të ngulitura *end, endës, e enjte, femër, e premte, vendim, vendos* (te këto dy të fundit me zhvendosjen e theksit gjatë fjalëformimit *e-ja* ka mbetur e patheksuar), ka lëkundje në shqiptimin e *brenda, i dendur, më dhemb, dhentë, mendje, vend, zemër* etj.<sup>29</sup>

Përveç këtyre çështjeve kryesore, që në disa raste kanë një varg nënçështjesh, ka edhe një numër çështjesh të tjera më të veçanta, disa prej të cilave paraqesin vështirësi jo të paka, si p.sh. mënyra e shqiptimit (këtë radhë në vartësi nga kjo edhe e shkrimit) të disa fjalëve e emrave të përveçëm të huaj. Normalizimi i shqiptimit është një nga detyrat më të rëndësishme dhe më të ngutshme për kulturën e gjuhës. Normat e shqiptimit letrar duhet të zbatohen detyrimisht në shkollë, në teatrot, në radio e televizion, në filmat, në leksionet e bisedat etj. Del si detyrë që të hartohet sa më parë një projekt i «Rregullave të drejtshqiptimit të shqipes», i cili të diskutohet ashtu si «Rregullat e drejtshkrimit» dhe të botohet pastaj në një formë përfundimtare, duke u bërë i detyrueshëm. Për këtë qëllim duhet nisur pa vonesë nga puna, duke caktuar që në fi-

29) Në artikullin e cituar A. Dodi për disa çështje ka një qëndrim të ndryshëm nga ai që parashtruam më lart, p.sh. ai e quan si «rregull të nxituar» shqiptimin e *e-së* si të tillë në të gjitha rastet kur ndodhet para një bashkëtingëlloreje hundore dhe për disa fjalë quan si më të pëlqyer shqiptimin e saj si *ë (zëmër, vënd, vë* etj.), për togun *ue* thotë se mund të shqiptohet edhe si i plotë, shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme fundore ose para një të shurdhëte tjetër (*djek, diqte* etj.) e quan si normë të «toskërishtes letrare». Autori i ka përligjur këto qëndrime të tij me mungesën në atë kohë të një gjuhe të vetme letrare kombëtare. A. Kostallari në artikullin e cituar «Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare», duke renditur veçoritë kryesore të strukturës fonetike, e ka marrë si të arritura ndonjë tipar që, pas vëzhgimeve tona, sot për sot përbën ende një tendencë, p.sh. mosshurdhimi i të zëshmeve fundore, kurse mendimi i tij se mbizotëron prirja për të ruajtur *ë-në* e patheksuar në rastet kur kjo u takon morfemave trajtëformuese e fjalëformuese në rrokjet që vijnë menjëherë pas theksit (*bukurisë, drutë, janë, kthesë, frymë, i thatë* etj.) dhe se ruhen grupet zanore *ue, ye (sulmues, i pathyeshëm)* është i vërtetë vetëm përsa i përket shkrimit, po jo strukturës fonetike të shqipes letrare.

llim drejt kriteret e saj, metodikën e vëzhgimeve dhe duke përdorur për këto vëzhgime në një masë të nevojshme aparatet për regjistrimin e zërit.

Për sa i takon gramatikës, kultura e gjuhës duhet të vëzhgojë shman-gjet më tipike e më të rëndomta nga norma e sotme dhe të hetojë burimet e tyre (ndikime të dialekteve, të gjuhëve të huaja etj.) Zbatimi i normave morfologjike është një nga shenjat më të dukshme të kulturës së gjuhës dhe duhet synuar që shmangjet e gabimet në fushën e trajtë-formimit të zhduken nga gjuha e shkruar sa më parë. Në fushën e sintaksës detyra më e rëndësishme është ruajtja e veçantisë kombëtare të shqipes prej ndikimit të modeleve të huaja dhe theksimi e zhvillimi i atyre mënyrave e mjeteve sintaktike që përbëjnë këtë veçanti kombëtare. Duke pasur parasysh këtë, mendojmë se «Sintaksa e shqipes së sotme letrare», që është duke u hartuar nga një grup gjuhëtarësh, do t'u japë një vend të mirë ndërtimit të togfjalëshave dhe topikës në përgjithësi, pasi këtu vihen re më të shumta e gabimeve sintaktike. Një tjetër çështje që i takon jo vetëm sintaksës, por, në një kuptim më të gjerë edhe ortopesisë, është studimi i intonacionit të gjuhës shqipe, një detyrë me rëndësi të madhe për teatrin, radion, e në përgjithësi për fjalën artistike. Mjerisht, në këtë fushë sot për sot nuk kemi asnjë studim, por besojmë se gjatë hartimit të «Gramatikës së gjuhës shqipe letrare» edhe këtij elementi, që në fushën e sintaksës po i jepet një rëndësi përditë e më e madhe, do t'i kushtohet vëmendja e duhur e do të kemi disa përfundime të para në studimin e tij.

Por ajo që ndoshta përbën thelbin e kulturës së gjuhës ose që kuro-rezon gjithë punën dhe kujdesin për zhvillimin e gjuhës letrare, është stilistika, shkenca që studjon stilin, një fushë e gjerë kjo, ku gjer tashti s'janë hapur veçse brazdat e para. Kultura e gjuhës duhet të ndihmojë për diferencimin dhe zhvillimin e stileve të ndryshme, për përcaktimin e mjeteve specifike të këtyre stileve, dhe kjo nuk duhet parë aspak si një «prishje e njësisë» së gjuhës, por përkundrazi është shkalla më e lartë e zhvillimit të saj. Njësia e gjuhës jo vetëm nuk e mohan, por, përkundrazi, e parakupton dhe kërkon diferencimin stilistik, sepse, megjithëse gjuha është mjet komunikimi për gjithë shoqërinë, pikërisht për ta kryer sa më mirë këtë komunikim, në vartësi nga rrethanat e veçanta të funksionimit dhe nga «orientimi individual» i folësit (ose i atij që shkruan) bëhet një zgjedhje e mjeteve leksikore, frazeologjike<sup>30</sup> e gramatikore. Në këtë mënyrë formohen në gjuhë stilet e ndryshme (stili letrar, zyrtar, akademik, publicistik, shkencor, vulgar etj.), d.m.th. nënsisteme të gjuhës me mjete më pak a më shumë të veçanta.

4. Për ngritjen e përgjithshme të nivelit të kulturës së gjuhës duhen krijuar mjetet e nevojshme, duhen gjetur rrugët më të përshtatshme e duhen kapur hallkat kryesore. Këtu, siç e pamë, ndodhemi para një lisi të madh, që nuk mund të pritet me një të rënë të sëpatës. Do të fillohet, natyrisht, nga punët më të ngutshme e më të nevojshme, po jo gjithmonë nga më të thjeshtat. Duhet hartuar pra një varg veprash që të shpien në masat në mënyrë të qartë e të kuptueshme rezultatet e punës së gjuhëtarëve në këtë fushë. E para prej tyre do të jetë sigurisht libri me «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes», të hartuara në një formë

30) Është për t'u përhëndetur që në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe do të jepet për herë të parë edhe karakteristika stilistike e fjalëve (A Kostallari, *Gjashtëdhjetëmijë fjalë të gjuhës amtare* në «Ylli» 1969 nr. 6, f. 144).

përfundimtare pas diskutimit që po zhvillohet. Duke u bërë të detyrueshme ligjërisht, këto rregulla do t'u japin fund njëherë e mirë luhatjeve drejtshkrimore dhe do të ndihmojnë për normalizimin dhe njësimin e mëtejshëm si të ortoepisë, ashtu edhe të disa çështjeve gramatikore. Por nuk duhet menduar se me këtë do të jetë i tepërt çdo diskutim i mëtejshëm rreth drejtshkrimit. Gjuha zhvillohet, pasurohet, dalin probleme të reja, dhe, veç kësaj, as që mund të themi se i njohim të gjitha problemet që shtrun drejtshkrimi edhe në gjendjen e sotme të zhvillimit të gjuhës. Prandaj vëmendja jonë duhet të hetojë si rastet kur një rregull e drejtshkrimit mund të hyjë në kontradiktë me parimet dhe me realitetin gjuhësor, ashtu edhe çështjet që mund të kenë mbetur të patrajuara në rregullat. Kështu herë pas here mund të bëhen saktësime ose shtesa, përdërisa të mos jetë bërë i nevojshëm një rishqyrtim i rregullave në tërësi. Bashkë me rregullat e reja të drejtshkrimit ose menjëherë pas tyre është e nevojshme të botohet «Fjalori drejtshkrimor», i punuar disa vjet përpara prej prof. Mahir Domit. Ky fjalor është shumë i nevojshëm, sepse jo të gjithë do të jenë në gjendje t'i përvetësojnë rregullat në mënyrë të tillë, që të nxjerrin prej tyre përgjigjen e drejtë për çdo pyetje që mund të lindë në të shkruar e sipër. Veç kësaj, «Rregullat» vetë do të trajtojnë ato fenomene për të cilat mund të caktohet një rregull, kurse të tilla çështje si shkrimi i *rr*-së, i *h*-së, i mjaft fjalëve të huaja etj. mund të pasqyrohen në mënyrë të plotë vetëm në «Fjalorin drejtshkrimor», i cili ka edhe një lehtësi shumë të madhe përdorimi, në krahasim me «Rregullat».

Me drejtshkrimin lidhet ngushtë edhe problemi i transkribimit nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe. Për këtë nuk ka asnjë rregull të caktuar dhe gjithësecili vepron sipas mënyrës së vet. Veçanërisht i vështirë paraqitet ky problem në rastin e gjuhëve që nuk përdorin alfabetin latin. Mungesa e parimeve këtu ka sjellë jo pak ngatërresa në punën bibliotekare. Mendojmë se i bie barra komisionit të drejtshkrimit që, pas përfundimit të punës që ka në duar, t'i hyjë edhe këtij problemi për t'i dhënë një zgjidhje të kënaqshme e përfundimtare. Ndërkaq, për të ecur më shpejt kjo punë, mund të bëhen qysh tani disa përgatitje paraprake.

Për sa i takon drejtshqiptimit, duhet vepruar ashtu si në rastin e drejtshkrimit, duke hartuar një projekt për diskutim. Duhet bërë përpjekje që kjo punë të nisë që vitin e ardhshëm, pasi nevoja për të vënë rregulla të sakta në këtë fushë po bëhet përditë e më e mprehtë.

Pastrimi i gjuhës nga fjalë e shprehje të huaja, është gjithashtu një detyrë e ngutshme dhe me rëndësi kombëtare. Rubrika e veçantë që ka hapur revista «Ylli» dhe artikujt që botohen herë pas here në shtypin periodik janë punë e vlefshme, por e pamjaftueshme. Duhet bërë diçka e ngjajshme me librin e A. Xhuvanit «Për pastërtinë e gjuhës shqipe», duhet pra një «Fjalor i fjalëve të huaja të zëvendësueshme» (plotësisht ose pjesërisht), ku të renditen të gjitha fjalët e huaja që mund të zëvendësohen me fjalë shqipe, duke dhënë në një masë të mjaftueshme shembëlla të bukura e të goditura të përdorimit të tyre. Nevoja ose më mirë domosdoshmëria për një fjalor të tillë bëhet edhe më e ndjeshme po të kemi parasysh rrethanën që «Fjalori» i ri i shqipes do të dojë një kohë jo aq të shkurtër që të përfundojë<sup>31</sup>). Kështu që shumë prej fjalëve me burim vendës të këtij fjalori, të cilat do të mund të zëvendësojnë një

31) «Ky fjalor... do të ketë rreth 60 mijë fjalë e do të botohet në disa vëllime. Libri i tij i parë do të bëhet gati për shtyp në vitin 1970» (Po ai, Po aty).

numër fjalësh të huaja ose të ndaloni hyrjen e të tjerave, do të vonojnë të vihen në qarkullim e të njihen prej gjithë atyre që kanë nevojë për to. Dhe në pastrimin e fjalëve të huaja vështirësitë dhe siguria e suksesit janë në përpjestim të zhdrejtë me jetën e fjalës së huaj në gjuhë. Me të drejtë A. Kostallari shkruan: «Pse të thuhet p.sh. *tracé, traversé, frontepic, zitëlë, fermentohet, rezistent* etj. kur për to kemi përkatësisht fjalët *brezor, kryqëzore, ballinë, lëneshë*<sup>32</sup>, *zjarriset, qendrak* etj.»<sup>33</sup> Por këto fjalë e shumë e shumë të tjera si këto, që ka kartoteka e leksikut të shqipes, duhet të vihen në qarkullim sa më parë që të jetë e mundur. Veç kësaj dobie praktike «Fjalori i fjalëve të huaja të zëvendësueshme», duke u ribotuar me përmirësime e shtesa herë pas here, do të gjallërojë përpjekjet e një mase të gjerë njerëzish të apasionuar, të cilët, siç e tregon përvoja e derisotme, mund të gjejnë fjalë e shprehje jo më pak të përshtatshme se ato të gjuhëtarëve. Ky «Fjalor» do të bënte njëkohësisht edhe një lloj kodifikimi, duke ndrequr disa gabime që vihen re në zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë shqipe<sup>34</sup>. Grupi i kulturës së gjuhës gjatë vëzhgimeve mbi gjuhën e shtypit e të botimeve të tjera, duhet të ketë parasysh që të mbledhë lëndë për hartimin në të ardhmen edhe të një fjalori mbi përdorimin e drejtë të fjalëve, ku të renditen ato fjalë në përdorimin e të cilave vihen re gabime.

Në fushën e terminologjisë është e nevojshme që puna të marrë disa tipare të reja. Terminologjia teknike tani duhet të dalë në plan të parë, pasi në të vihet re një numër mjaft i madh fjalësh të huaja, shumica italishte, që po dalin gjithnjë e më shpesh edhe në faqet e shtypit. Terminologjia shkencore që ka mbetur gjer tani pa u përpunuar mund të shtyhet për një kohë më të pastajme. Pra edhe në këtë fushë duhet kapur «hallka kryesore». Veç kësaj, terminologjia nuk duhet të mbetet vetëm punë e disa komisioneve. Duhet gjallëruar puna me pjesëmarrjen e sa më shumë specialistëve. Për këtë duhen organizuar biseda në qendra pune e prodhimi, me qëllim që të shpjegohet rëndësia e çështjes, duhen botuar disa artikuj ose ndonjë broshurë shkencore-popullore dhe duhen hapur disa rubrika me vërejtje e propozime për termat në gazetën «Puna» e në revista si «Bujqësia socialiste», «Shëndetësia popullore», «Ekonomia popullore», «Drejtësia popullore», «Revista politike-ushtarake», «Teknika», «Ndërtuesi» etj. Redaksitë përkatëse duhen ndihmuar që t'i mbajnë vetë këto rubrika, të cilat nuk do të kenë si qëllim të vetëm pastrimin e terminologjisë, po edhe njësimin e saj, sepse në rrethe të ndryshme, nëpër ndërmarrje të ndryshme për të njëjtat mjete ose procese pune përdoren terma të ndryshme.

Një «Gramatikë e gabimeve», e hartuar në një mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe tërheqëse, do të ishte një mjet i pazëvendësueshëm për të luftuar shmangjet e gabimet gramatikore që vihen re. Mjaft e vlefshme do të ishte gjithashtu edhe një gramatikë normative e shkurt-

32) Kjo fjalë ndoshta jo e përshtatshme nga pikëpamja etike.

33) *Po aty*.

34) Kështu p.sh. kujtohet pa të drejtë se *tendencë* (nga fr. *tendance*) mund të zëvendësohet me «prirje». Vetëm kështu e përkthen këtë fjalë edhe V. Kokona në «Fjalorin frëngjisht-shqip», hartuar prej tij (Tiranë 1966 f. 320). Përveç vështirësisë së formimit prej kësaj fjale të mbiemrit me kuptimin «tendencioz» dhe të emrit me kuptimin «tendenciozitet», këtu ka edhe një pasaktësi kuptimore, se *prirje* do të ishte frëngjisht *disposition* (pour); *inclination*, kam *prirje për* — *avoir un penchant pour...*, *être disposé à ...*, pra mosdallimi i *prirjes* nga *tendence* është më i dëmshëm se përdorimi i fjalës *tendencë*.

tër dhe e thjeshtë, e hartuar për një publik sa më të gjerë. Po ta mbajmë parasysh nevojën dhe po ta ushqejmë idenë e krijimit të këtyre veprave, besoj se nuk do të jetë e largët dita kur këto do të marrin trajta konkrete. Por para tyre dhe pavarësisht nga ato duhet zgjidhur problemi i përdorimit të shenjave të pikësimit. Gjatë diskutimeve për drejtshkrimin kudo është kërkuar me forcë hartimi edhe i «Rregullave të pikësimit». Në këtë fushë, veç gjërave të qarta e të padiskutueshme, ka ende sot shumë subjektivizëm, ndjekje të traditës së disa gjuhëve të huaja. Nuk do të jetë e lehtë të kapërcehen vështirësitë që lidhen me forcën e traditës dhe të caktohen rregulla pikësimi duke u nisur nga vengantia e strukturës dhe e intonacionit të shqipes, por, sidoqoftë, hartimi i një projekti nga ana e grupit të sintaksës (një nga tri grupet që punojnë për hartimin e «Gramatikës së gjuhës shqipe letrare») është një punë që nuk duron të shtyhet më tej, po të marrim parasysh kërkesat e shkollës, të shtypit etj.

Hartimi i një stilistike të gjuhës shqipe tani për tani mbetet vetëm një ide tërheqëse. Në këtë fushë përvoja jonë është e pakët. Duhet sqaruar më parë disa çështje teorike të përgjithshme, duhet vendosur rrethi i problemeve që do të trajtojnë kjo stilistikë dhe pastaj duhet mbledhur lënda e nevojshme. Në këtë mes është me rëndësi që kjo stilistikë, e cila pa dyshim do të përfitojë edhe nga përvoja e gjuhëve të tjera, të ketë një karakter sa më origjinal, të dalë në mënyrë të natyrshme nga vetë lënda e problemet e veçanta të shqipes. Një punë e nevojshme që do të shërbejë si një farë përgatitjeje për këtë stilistikë është studimi i gjuhës dhe stilit të disave nga shkrimtarët tanë më të mirë, kryesisht të sotmit. Kjo do të ketë edhe një rëndësi praktike për përmirësimin e gjuhës së letërsisë sonë artistike dhe do të plotësojë një mungesë shumë të ndjeshme në studimet tona filologjike.

Siç shihet, para kulturës së gjuhës hapet një fushë e gjerë pune. Kjo degë e re e gjuhësisë është e re edhe nga një pikëpamje tjetër. Ajo tërheq, intereson dhe ndihmon një numër shumë të madh njerëzish që nuk janë gjuhëtarë dhe ne duhet të përpigëmi që ky numër të shtohet e të bëhet përherë e më i madh. Veç problemeve që u përmendën më sipër, përditë praktika nxjerr një varg çështjesh të vogla, por disa herë të rëndësishme që duhen diskutuar, që kërkojnë një përgjigje. Përveç kësaj, veprimtaria për kulturën e gjuhës nuk mund të ketë sukses, po nuk u edukua dashuria për gjuhën amtare, ndjenja e përgjegjësisë dhe qëndrimi i ndërgjegjshëm ndaj saj. Për këtë duhet mbajtur e gjallë në shtyp e në radio-televizion një fushatë për shpërgjimin e propagandimin e kërkesave të kulturës së gjuhës dhe për ndreqjen e gabimeve të ndryshme. Por vetë jeta po shtron para nesh nevojën që kultura e gjuhës të ketë një organ të saj, që të bëhet tribuna e kujdesit për gjuhën amtare dhe e luftës për pastërtinë e saj. Ka disa arsye që e bëjnë të nevojshme një revistë të tillë. Së pari, problemet e kulturës së gjuhës janë të tilla që nuk mund të trajtohen të gjitha me anë artikujsh të shkurtër të botuar në «Drita», «Mësuesi», ose «Ylli»; artikujt e gjatë të kësaj natyre mendojmë se nuk do të ishin në pajtim as me profilin e «Studimeve filologjike». Së dyti, gazetat, po ashtu edhe revista si «Ylli», kanë një vlerë të kufizuar në kohë dhe kanë gjithashtu nga një rreth lexuesish të vetin, ndërsa rrethi i lexuesve të «Studimeve filologjike» është, siç dihet, shumë i kufizuar<sup>35</sup>. Kështu që artikujt e botuar në këto ose

35) Tirazhi i numrit të fundit të kësaj reviste është 1500 dhe një pjesë e mirë e tyre shkojnë jashtë shtetit.

nuk arrijnë të lexohen prej atyre që duhet t'i lexojnë, ose lexohen dhe pas një kohe harrohen. Të duash të kërkosh pastaj një gazetë ku ka qenë botuar iks artikull, nuk është punë e lehtë. Së treti, ka probleme të tilla të kulturës së gjuhës që gazetat ose revistat nuk do ta gjenin të përshtatshme t'i botonin: shpjegim fjalësh të rralla e të panjohura që dalin si domos në letërsinë artistike shqipe ose të përkthyer dhe nuk gjenden në «Fjalorin e gjuhës shqipe» (Shërbimi gjuhësor ka herë pas herë kërkesa të tilla), shpjegim fjalësh e shprehjesh të huaja, botim fjalësh të reja të panjohura, të vlefshme për t'u përdorur në gjini të ndryshme të gjuhës, rekomandime për zëvendësim fjalësh të huaja, përgjegje pyetjeve të lexuesve, anketa për normën e gjuhës letrare, drejtuar shkrimtarëve, mësuesve etj. Së katërti, në diskutimin e problemeve të kulturës së gjuhës dhe të normalizimit të gjuhës letrare duhet të tërhiqet një numër sa më i madh njerëzish, veçanërisht nga radhët e arësimitarëve, shkrimtarëve, redaktorëve e korektorëve letrarë, gazetarëve e korrespondentëve vullnetarë etj. Kjo është e vështirë të arrihet, po nuk u përqëndrua puna në një organ të vetëm. Si çdo punë tjetër, edhe kjo, që të vejë mbarë, duhet të përqëndrohet. Së pesti, vendi më i përshtatshëm për botimin dhe diskutimin e disave nga punët që do të kryhen në fushën e kulturës së gjuhës, p.sh. rregullat e pikësimit, të drejtshqiptimit, të transkribimit dhe të të tjerave probleme të ngjashme nuk mund të jetë veçse një organ i tillë.

Kjo revistë mendojmë të dalë dy herë në vit dhe të nisë që vitin e ardhshëm, në fillim qoftë edhe me 3-4 fashikuj të një formati të përshtatshëm për natyrën e saj. Ajo besojmë se do të bëhet shpejt një libër tryeze, i dashur për gjithë arësimitarët e punonjësit e tjerë që kanë të bëjnë përditë me probleme gjuhe, për të gjithë ata që e kanë për zemër të interesohen për gjuhën amtare, dhe do të krijojë kështu shpejt rreth vetes një aktiv të gjallë bashkëpunëtorësh të rregullt.

Një kusht tjetër i domosdoshëm për ngritjen e nivelit të kulturës së gjuhës është kualifikimi profesional i korektorëve e redaktorëve prej të cilëve varret shumë në këtë fushë. Është e nevojshme që t'i jepet fund diletantizmit në këtë punë, të gjenden forma të përshtatshme kualifikimi dhe të hapet pranë Fakultetit të historisë e të filologjisë një degë për redaktorë letrarë, të cilën duhet ta ndjekin edhe studentët e degës së gazetarisë. Është e tepërt të përsërisim ndikimin e madh të shtypit e të botimeve të tjera në zhvillimin e gjuhës letrare dhe në përcëimin e normave të gjuhës letrare në masat.

«Që të shkruash gjuhën shqipe, — thoshte Asdreni, — s'është punë e rëndë, po s'është as aq e lehtë».<sup>36</sup> Këtë të vërtetë të pamohueshme duhet ta ndjejnë të gjithë. Ajo na mëson të mos i mbivlerësojmë vështirësitë dhe të mos i reshim përpjekjet për të arritur qëllimin. Kjo duhet të bëhet shprehi, që në moshën më të re. Barra e kësaj detyre i bie shkollës, punës dhe ndërgjegjes së mësuesve. Në mësimin e gjuhës shqipe në shkollë, siç thotë shoku Enver, duhet synuar «për një përvetësim me baza më të shëndosha dhe një aftësi më të madhe të përdorimit praktik të gjuhës së gjallë nga ana e nxënësve».<sup>37</sup>

Shumë nga gabimet gjuhësore që vihen re sot e kanë burimin te dobësitë e mësimin të gjuhës në shkollë. Problemet e kulturës së gjuhës

36) Asdreni, «*Rreze djelli*» (Parathënie), Bukuresht 1904, f. 5.

37) Enver Hoxha, *Për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë* në «*Studime filologjike*», 1968 1, f. 13.

në shkollë meritojnë të shqyrtohen në mënyrë të veçantë dhe të nxirren përfundimet e nevojshme për t'u pasur parasysh si për ndërtimin e programeve ashtu edhe për hartimin e teksteve. Shkolla duhet vlerësuar si faktori më i rëndësishëm në procesin e formimit gjuhësor të njeriut.

Kultura e gjuhës shtron pra para nesh një varg detyrash me rëndësi të madhe teorike dhe praktike, kombëtare dhe shoqërore. Gjuhësia jonë, duke u mbështetur në metodologjinë marksiste dhe me përkrahjen e vazhdueshme të Partisë e të shtetit tonë socialist do t'i përmbushë në kohën e duhur kërkesat që shtron para saj zhvillimi i vrullshëm ekonomik e kultural-arësimor i vendit. Për kryerjen e këtyre detyrave, bashkë me gjuhëtarët duhet të rreshtohen në këtë front të gjerë pune të gjithë arësimtarët, shkrimtarët (prej të cilëve duhet kërkuar me insistim më shumë) gazetarët, punonjësit e tjerë të shkencës e të kulturës, të gjithë ata që e ndjejnë përgjegjësinë ndaj gjuhës amtare dhe që e kuptojnë se gjuha është një armë e fuqishme e përparimit dhe e zhvillimit të shoqërisë.

#### L I T E R A T U R E

- 1) Ahmanova, O.S., *Slovari lingvističeskikh terminov*, Moskva 1968.
- 2) *Aktualnye voprosy kulturny reči* në «Voprosy kulturny reči» 7, Moskva 1966, ff. 11-14.
- 3) Budagov, R. A., *Jazykovye stili* në «Vvedenie v nauku o jazyke» Moskva 1958, ff. 396-418.
- 4) Bullygina, T. V., *Pražskaja lingvističeskaja školla. Issledovanija funkcionalnyh jazykov i stilej. Problema «Kulturny jazyka»* në «Osnovnyje napravlenija strukturalizma», Moskva 1964, ff. 113-122.
- 5) Desnickaja, A. V., *Iz istorii obrazovanija allbanskogo nacionalnogo jazyka* në «Voprosy formirovanija i razvitija nacionalnyh jazykov» Trudy Instituta Jazykoznanija Tom X, Moskva 1960, ff. 219-251.
- 6) Desnickaja, A. V., *O stilističeskoj funkcii turcizmov v allbanskoj poezii* në «Voprosy teorii i istorii jazyka» Sbornik v čest' professora B. A. Llarina, Leningrad 1963, ff. 88-95.
- 7) Desherijev, Ju. D., Protčenko, I. F., *O nekotoryh voprosah razvitija jazykovoju kulturny narodov SSSR* në «Voprosy jazykoznanija» 1966 2, ff. 3-16.
- 8) Dodi, A., *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë) Tiranë, 1963.
- 9) Dodi, A., *Probleme të ortoepisë shqipe dhe shkolla* në «Arësimi popullor» 1962 4, ff. 91-104.
- 10) Filin, F. P., *Neskolko slov o jazykovoju norme i kulturne reči*, në «Voprosy kulturny reči» 7, Moskva 1966, ff. 15-22.
- 11) Grigorjev, V. P., *Kultura jazyka i jazykovaja politika* në «Voprosy kulturny reči» 4, Moskva 1966, ff. 5-21.
- 12) Icković, V. A., *Jazykovaja norma*, Moskva 1968.
- 13) Kostallari, A., *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare* në «Shkencat shoqërore në shkollë» 2, Tiranë 1976, ff. 61-74.
- 14) Kostallari, A., *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»* në «Studime filologjike» 1963 2, ff. 43-128.
- 15) Kostomarov, V. G., Leontjev, A. A., *Nekotoryje teoretičeskie voprosy kulturny reči* në «Voprosy jazykoznanija» 1966 5, ff. 3-15.
- 16) Ozhegov, S. I., *O formah suščestvovanija sovremennogo russkogo nacionalnogo jazyka* në «Voprosy kulturny reči» 7, Moskva 1966, f. 5-8.
- 17) Ozhegov, S. I., *Očerednye voprosy kulturny reči* në «Voprosy kulturny reči» 1, Moskva 1955, ff. 5-33.
- 18) Ozhegov, S. I., *Sektor kulturny reči Instituta jazykoznanija AN SSSR i jego zadači* në «Voprosy jazykoznanija» 1953 1, ff. 152-155.
- 19) Rozental, D. E., *Kultura reči*, Moskva 1960.
- 20) *Tezisy Pražskogo lingvističeskogo kruzhka* në «Istorija jazykoznanija XIX-XX vekov v očerkah i izvlečenijah» II, Moskva 1965, ff. 123-140.
- 21) Vinogradov, V. V., *Russkaja reč, jejo izučenie i voprosy rečevoju kulturny* në «Voprosy jazykoznanija» 1961 4, ff. 3-19.
- 22) Vahek, J., *Lingvističeskij slovar' Pražskoj školly*, Moskva 1964.
- 23) Xhuvani A., *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 1956.

## R é s u m é

PROBLEMES ET TACHES  
DU RESSORT DE LA CULTURE DE LA LANGUE

L'auteur fait une brève exposition des problèmes et tâches de la linguistique albanaise qui sont du ressort de la culture de la langue. Aujourd'hui que le processus de la stabilisation de la norme littéraire est dans sa phase finale, que la propagation de cette norme se développe avec une rapidité sans précédent en raison du grand développement que connaît l'instruction publique et les formes différentes de la vie culturelle, l'activité parfaitement organisée dans le domaine de la culture de la langue est non seulement possible, mais aussi indispensable. Après avoir expliqué le sens et le contenu des termes culture de la langue, norme littéraire et codification, l'auteur traite un nombre de problèmes du ressort du lexique, de la phonétique, de la grammaire et de la stylistique. Dans le domaine du lexique, le problème le plus saillant, le plus inquiétant et le plus sujet à discussion continue de rester la substitution des barbarismes non strictement nécessaires.

L'auteur est de l'avis que dans ce domaine on ne fasse pas preuve d'un purisme excessif, puisqu'il entraîne une certaine archaïsation de la langue, ce qui semble heurter le goût général linguistique de nos jours. Au contraire, il rejette avec fermeté l'indifférence envers les mots étrangers, qu'on observe dans certains organes de presse et chez des auteurs particuliers. Afin de donner une solution à ce problème, il propose l'élaboration d'un Dictionnaire des barbarismes remplaçables, qui indiquât comment doit-on substituer les barbarismes usités sans une stricte nécessité en albanaise.

En attirant l'attention aussi sur les usages erronés d'un nombre de mots albanaïses et étrangers, l'auteur voudrait que les cas les plus typiques et qui se répètent le plus souvent soient réunis et publiés sous la forme d'un manuel.

En passant à la question de la terminologie, après avoir fait noter que jusqu'à présent ont été édités 15 dictionnaires terminologiques comptant 20.984 termes, l'auteur propose de donner la priorité à l'élaboration des termes des sciences humaines et des termes techniques, puisque de ces disciplines pénètrent de plus en plus dans le lexique général de la langue des barbarismes étrangers. L'accroissement de la part du lexique terminologique dans le lexique général constitue une caractéristique du développement de la langue albanaïse de nos jours. Afin d'améliorer le travail dans le domaine de la terminologie, l'asseoir sur des bases scientifiques plus solides, l'auteur propose que, sans faire passer en arrière-main l'élaboration des nouveaux dictionnaires des termes, l'on fasse un examen théorique général du travail fait jusqu'à présent, pour étudier les types et les modes les plus productifs de la formation des termes, les principes du perfectionnement et de l'épuration des termes, les critères de constitution en terme des mots dialectaux, la concordance des termes avec les normes de la langue littéraire, etc.

Dans le domaine de la phonétique, l'orthographe et la prononciation constituent deux problèmes intéressants, dont la solution a un caractère urgent. Le projet de l'orthographe de l'albanaïse, paru au commencement

de 1967, après les discussions intervenues, sera réélaboré et deviendra obligatoire. Pour la solution de quelques questions difficiles que présente l'orthographe de l'albanais, comme l'écriture de l'è prétonique et postonique et l'écriture des mots unis ou séparés par un trait d'union, on doit faire préalablement des études particulières pour saisir le problème dans son ensemble et en détail. Pour ce qui est de l'orthoépique (jusqu'à présent n'a pas été édité quelque guide orthoépique), l'auteur, après avoir fait ressortir l'absence des études et des règles dans ce domaine, ainsi que les circonstances objectives qui ont apporté cet état de choses, demande l'élaboration d'un projet orthoépique, qui soit discuté ensuite publiquement. Il soumet aussi son opinion sur quelques questions sujettes à discussion de l'orthoépique de l'albanais littéraire.

La culture de la langue s'est mis pour tâche, dans le domaine de la grammaire, d'examiner les écarts les plus typiques et les plus fréquents à la norme littéraire et d'examiner leurs sources (influences des dialectes, des langues étrangères). L'auteur a attiré l'attention surtout sur la conservation de la particularité nationale de l'albanais dans le domaine de la syntaxe, où sont observées plusieurs influences des modèles étrangers. Outre les articles de divulgation dans la presse périodique et la rubrique linguistique dans la radio-télévision, l'auteur propose l'élaboration d'une Grammaire des erreurs d'une façon simple et attractive. Aux problèmes de la syntaxe l'auteur rattache aussi l'étude de l'intonation de l'albanais et la fixation définitive des règles de ponctuation, exigées particulièrement par l'école et les maisons éditrices.

En passant dans le domaine de la stylistique, l'auteur admet les difficultés qu'offre pour le moment l'élaboration d'une stylistique de la langue albanaise, du fait que l'expérience de la langue albanaise dans cette voie est faible, mais il propose que cette tâche ne soit pas laissée en arrière-main. A son avis, il faut ranimer la discussion des problèmes de la stylistique et il faut entreprendre des études pour la langue et le style de quelques-uns des meilleurs écrivains albanais.

Après tout cet exposé, l'auteur propose qu'on commence la publication d'une revue spéciale, qui devienne la tribune des débats sur les problèmes de la culture et de la langue. Il range plusieurs raisons qui, à son avis, rendent des plus nécessaires la parution de cet organe. En terminant son article, l'auteur s'arrête notamment sur le rôle de l'école pour la formation linguistique des élèves. Il insiste sur un travail plus soigneux et plus passionné de la part des étudiants de la linguistique et un reflet meilleur des problèmes de la culture de la langue sur les programmes et les livres des matières linguistiques.